



Republika e Kosovë
Komuna e Drenasit
Kuvendi i Komunës

Nr. 12-030/01-16585 dt. 27.05 2020



PROCESVERBALI

I mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të mbajtur më dt. 20.05.2020, ora 10:00.
Mbledhjen e kryesoi Labinot Halilaj-Kryesues.

Kryesuesi deklaroi të hapura punimet e mbledhjes të Komitetit për politikë dhe financa ku të pranishëm ishin anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa: Kryesuesi i Komunës Labinot Halilaj, Gani Podrimqaku, Florentina Elezi, Fitore Morina, Edolina Plakiqi, Burim Bujupi. Prezent gjatë mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa ishin: shefi i Kabinetit të Kryetarit Flamur Curri, Drejtori për Buxhet dhe financa Shyqyri Bublaku, Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë: Ruzhdi Lestrani.

Komiteti filloi punimet më këtë:

Rend dite:

1. Procesverbali i mbledhjes së Komitetit për Politikë dhe Financa të dt. 20.03.2020.
2. Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrave, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat.
3. Raportimi i Kryetarit për pjesën e mjeteve financiare të shpenzuara për menaxhimin e situatës nga COVID -19.
4. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020, me ndryshime.
5. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit, Labinot Halilaj: hapi mbledhjen e KPF, pasi përshëndeti të pranishmit, prezantoi rendin e ditës, i njoftoi anëtarët e KPF-së se kemi edhe një pika shtesë për rendin e ditës: 1. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020, me ndryshime sipas rekomandimeve të Ministrisë së Financave me ndryshim për 0.08 cent intervenim prej thesarit.

Pasi nuk pati diskutime **tjera Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj**- hodhi në votim rendin e ditës së bashku me një pikë shtesë, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtarë:

Për votuan 6 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj- hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës: 2. Procesverbali i mbledhjes së rregullt të Kuvendit Komunal të dt. 30.04.2020.

Pasi nuk pati diskutime **Kryesuesi i Kuvendit** - hodhi në votim pikën e parë të rendit të ditës prezent gjatë votimit ishin 6 anëtarë:

Për votuan 6 anëtar

Kundër nuk pati.

Abstenim nuk pati.

Kaloim te pika e dytë e rendit të ditës: 2 Propozim Vendim për shpalljen e interesit të përgjithshëm publik të ngastrave kadastrave, në të cilat ndodhen burimi i ujit të pijes dhe rezervari i ujit ku ndodhet edhe objekti në të cilin janë të vendosura edhe pompat.

A ban një hyrje, një prezantim në pika të shkurtra zoti Lestrani.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-përshëndetje për të gjithë, para jush është një propozim vendim për shpalljen në interes të përgjithshëm në interes publik të ngastrave kadastrale në të cilat ndodhet burimi i ujit të pijeshëm të cilat ngastra është ba një investim nga nderkomartë për një periudhë kohore pesë gjashtë vjeçare aty janë funizu banorët e Krejkovës dhe një pjesë e banorëve të Drenasit nga ky rezervar burim i ujit, po prona si pronë është pronë private. Tash kena mi perdor procedurat që Ligji nuk na lejon me ba as një marrveshje me pronarë, me asnjë pronar, por mujna me ba nese pajtojnë momerandum që me shku me procedura ma të shpejt që mos mu vonu me procedura të shpronsimit për ndryshe të gjitha pronat që ka investua Komuna dhe do të investon Komuna duhet me dalë në emer të Komunës në bazë të Ligjit, L/092, ai i parasheh mu kthye në pron të Komunës masparitani mu ba investimi prej shteti ose nga ni donator dometha siç ketë të njoftum aty janë rezervari janë pompat veq procedura e titullarit duhet mu ndrushu.

Faleminderit shumë a ka dikush diçka po zoti **Burim Bujupi**: faleminderit kryesues përshendetje për të gjithë sëpari informacioni ke shumë i mangët dhe i shkurt prej drejtorit ishe ka mirë me na jap pak sqarim ma tepër ju thatë se është ndertu rezervart edhe pompat prej një investitorit ndërkombtar sigurisht se shënimet janë dikund dhe ekzistoin me na tregu sakëtsishtë, e dyta tha se çdo investim që e bën Komuna kthehet në pronë Komunale atëher Komuna ska investua kurgja për mu kthye në pronë Komunale, dhe a keni bisedua me pronarin se sa e ka interesin aj per me ja jap Komunës këtë pronë.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani-na tash jem duke folur për ligj të ri se ligji i vjetër kur ka qenë atëherë është bërë një marrveshje në mes pronarëve dhe Komunës për mu punësu dy vetë në atë kohë se na tash jem tuj fol për ligjin e ri, se nuk të le kërkoshe me ndërtua kurgja në pronë private pa pas marrëveshje paraprake se tash ligji i ri ka ndryshu.

Burim Bujupi me qfar këmbim apo me qfar mase ja ka jap pronën private për mi vendos pompat dhe rezerva,t kur ska të hyra të rrjedhshme që merr.

Drejtori për Gjeodezi Kadastër dhe Pronë Ruzhdi Lestrani -ka pas marrëveshje paraprake për mu punsu dy vetë mes pronarit dhe Komunës dhe ujësjellësin dhe janë punsu . Kena bisedu na me pronarin dhe aj ka paraqit kërkesat e veta që na me bërë marrëveshje me ta, aji spo donë me ba as shpronësim e as nuk donë këmbim por kërkon me bërë marrëveshje me ja puënsu dy vetë në ujësjellës. Na nuk na lejon ligji me bërë marrëveshje,nuk mundemi me i tha ne kompanisë me ja marr dy vetë në punë. Këmbim nuk donë veç mi shti dy vetë në punë jo në vend të Komunës po na me ba marrëveshje me ujësjellësin rajonal Prishtina dhe pronarin për me ja marr dy vetë në punë mi tha na ujësjellësit me ja marrë dy vetë në punë familjes Podrimqaku.Ata s'pranojnë marrëveshje gojore vetëm me shkrim. Të ujësjellësit skan pranë se është e kundërligjshme na kemi fol me ta ndryshe këta pa shkrim s'pranojnë këmbim s'pranojnë e vetmja mundësi është me fillu me shpronësim bashk me infrastrukturën përcjellëse,një ari e gjysmë është dhe njejt e ujësjellësit tjerat janë rrugë nga prona private ku është rrugë deri te rezervari duhet mu shpronësu. Burim Bujupi ne veç deshëm me pas një sqarim ma shumë se ne e rekomandoim për Kuvend, pasi që zoti Podrimqaku është anëtar i kuvendit ka qenë mirë me na fol pak ma tepër se është i qasaj lagje.

Gani Podrimqaku më falni se unë e kam axhë pronarin dhe kam vendos mos me fol e as me votu për mos me ndiku as ne komitet as ne Kuvend sa për sqarim e sqaroi drejtori.

Kryesuesi:a ka dikush diçka apo e rekomandoim për Kuvend me sqarime shtesë pra hedhim në votim se vota e kryesuesit në këso raste është e dyfishtë votojmë:

Për votuan 3 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim 3.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës: 3 Raportimi i Kryetarit për pjesën e mjeteve financiare të shpenzuara për menaxhimin e situatës nga COVID -19.

Meqë kryetari nuk është këtu me pas qenë këtu e kish sqarua vetë,a e do dikush fjalën po zoti Bujupi.

Burim Bujupi:faleminderit unë me sa e kam pranuar materialin raporti financiar për shpenzimet e rastit COVID-19, me shkrim nuk na ka ardh dhe nuk është hera e parë që nuk na vijnë raportet me shkrim ma herët për mu përgatit na ma mirë ka qenë se nuk është hera e parë që nuk vijnë materialet, ju lutem mos të përsëritet ma.

Kryesuesi kërkoi mirëkuptim për raportin sepse nga njëherë se ka mundësi me ndodhë një shpenzim brenda ditës vërejtjet me vend është se vërejtjet i marrë si gjana të mira se rasti covid është ende me për ndryshe me pas qenë Kryetari kish dha sqarim edhe ma shumë.

Kryesuesi po drejtor **Shyqyri Bublaku** një sqarim në pika të shkurta sa i përket shpenzimet për pandemi Komuna e Drenasit ka nda mjete prej 229200 €,prej tyre janë shpenzua deri më sot

85000€, nga granti qeveritar të cilat kanë shku për pako higjienike dhe pako ushqimore dhe 30.000, nga të hyrat vetanake do me tha shuma e gjithmbarshme deri më tash e shpenzuar është 115000€, janë në procedurë edhe 15000 €, për shpenzim dhe besoj se brenda dy tri ditë kryhet se është nxjerr urdhërblerja është vetëm ekzekutimi i pagesës. Domethënë 115000€ edhe 15000€ bëjnë gjithsej janë 130000€, besoj që financiarisht ju kemi përgjigje si Kuvend me financa për menaxhimin e pandemisë.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, rekomandim për kuvend, kalojmë te pika e katërt që ky propozim vendim është aprovuar në Kuvend me datën 30.04.2020, hapi diskutimin për pikën e katër të rendit të ditës: **4. Propozim Vendim për rritjen dhe bartjen të hyrave vetanake nga viti 2019 në vitin 2020, me ndryshime për 0.08cent.**

Drejtori i Financave Shyqiri Bublaku, është një gabim teknik prej 0.08 cent informatë që ka ardhur prej thesarit me shifra të plota. Në çdo dokumente, çdo raport që e bëjmë, çdo shkresë duhet me u bazu në raportet e friballancit nuk guxon mos me u bazu në ato janë dokumente bazike dhe ata na i kanë dërgua me shifra të plota. Këtu ka rrjedh ky gabim prej 0.08cent është ndryshimi dhe kemi marr shkresën prej departamentit të buxhetit zyrtarit analistit të buxhetit për Komunën e Drenasit dhe na kanë kërku që të bëjmë plotësim ndryshimin 0.08cent që duhet të shkoj në kuvend të behët ky ndryshim.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, i ftoj të votojnë për rekomandim për kuvend, prezent gjatë votimit ishin 6 anëtar:

Për votuan 6 anëtar

Kundër nuk pati

Abstenim nuk pati.


Kryesuesi i Kuvendit Komunal Labinot Halilaj, hapi diskutimin për pikën e pestë të rendit të ditës: **5. Të ndryshme.**

Pasi nuk pati diskutime, vërejtje apo sugjerime, kryesuesi i Kuvendit Komunal konsideroi si të mbyllur seancën.

Mbledhja përfundoj rreth orës: 10: 42 min.

Drenas 20.05.2020

Procesmbajtëse:


Zahrie Podrimqaku Subashi




Kryesuesi i Kuvendit
Labinot Halilaj